



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Raporti vjetor IADK 2010



RAPORT VJETOR- Aktivitetet e IADK-së gjatë vitit 2010

Viti 2010 për IADK-në (Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës) ka qenë një vit i suksesshëm në të gjitha drejtimet.

Ngritja kapaciteteve të organizatës ka ndodhur pas angnazhimit të konsulentëve të jashtëm (Z John Milligan dhe Znj Petra Feil) të cilët në bashkpunim me stafin profesional të IADK-së kanë riformuluar dhe adaptuar dy manualet kryesore të IADK-së: atë të prokurimit dhe atë të finacave të cilat janë aprovuar nga Bordi i Drejtove të IADK në dhjetor 2010.

Monitorimi dhe evaluimi i projekteve të IADK-së për vitin 2010 si dhe adaptimi i strategjisë 2007 2013 kanë përfaqësuar gjithashtu një kthesë dhe orietintim të qartë për IADK-në.

Ky vit karakterizohet si vit i shtimit të partnerëve dhe donatorëve siç janë Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, CoS, USAID/KPEP si dhe me zgjerimin e aktivitetve në tërë Kosovën; duke reflektuar në dyfishimin e stafit.

Pas përkrahjes së MBPZHR me subvencione fermerët kanë filluar të orientoohen nga rritja e fermës së tyre dhe kjo manifestohet edhe tek perfituesit e programit të IADK-së; sepse një pjesë e madhe e tyre kanë përfituar nga kjo përkrahje.

Për IADK-në edhe më tutje mbetet sfida ngritja e prodhimtarisë; cilësisë e sasisë dhe ulja e kostos së prodhimit.

Qëllim i IADK-së është:

Krijimi i një mjedisi socio-ekonomik më të zhvilluar në zonat rurale duke mbështetur aktivitetet bujqësore, ri-integrimin e njerëzve të kthyer, zbutjen e varfërisë, zvogëlimin e importit, promovimin e praktikave të mira bujqësore dhe zvogëlimin e papunësisë të të gjitha grupet shoqërore pa dallim feje, etniteti apo gjinie.

Gjatë këtyre viteve një kontribut të madh në ngritjen e kapaciteteve dhe në transferimin e aseteve tek IADK ka dhënë organizata Lutheran World Federation (LWF) e cila edhe më tutje është duke e ndihmuar IADK-në.

Objektivat tona për zhvillimin e bujqësisë janë duke u bërë realitet falë kontributit bujar të donatorëve: Evangelischer Entwicklungsdienst (EED) nga Gjermania dhe Finn Church Aid (FCA) nga Finlanda të cilat e kanë mbështetur programin e bujqësisë së Kosovës që nga paslufta; duke vazhduar akoma mbështetjen e këtij sektori përmes IADK-së.

Misionit të IADK-së janë duke i ndihmuar fermerët përfitues të cilët marrin guximin të hyjnë në projekte të reja pilote dhe në organizimin e tyre institucional përmes shoqatave dhe unioneve të shoqatave, të cilët me besnikëri janë duke aplikuar këshillat e ekspertëve të IADK-së.

Ne u jemi thellësisht mirënjohës dhe njëkohësisht i falendërojmë donatorët EED, FCA, LWF, USAID/KPEP dhe UNDP, partnerët, si dhe të gjithë përfituesit e programit të IADK-së, të cilët janë duke kontribuar në zhvillimin e bujqësisë në regjion dhe në gjithë Kosovën.

Zenel Bunjaku - Drejtor Ekzekutiv

Raport vjetor 2010

Mbështetur nga:

- FinChurcAid/Government of Finland (FCA/GoF)
- Evangelischer Entwicklungsdienst, Germany (EED)
- USAID/KPEP (Kosovo Private Enterprise Program)
- UNDP/UNKT (United Nations Kosovo Team)
- Lutheran World Federation (LWF)

Shtrirja e aktiviteteve: Komunat Mitrovicë, Vushtri, Skënderaj, Zveçan, Zubin Potok dhe Podujevë. Me projektin e USAID/KPEP në tërë Kosoven.

Kllasterët (sektorët) kryesorë të IADK-së janë:

- **Blegtoria**, ku përfshihen qumështi, ushqimi për kafshë, përmirësimi racor i lopëve dhe bletaria
 - **Pemët**, ku përfshihen mollat, kumbullat, dredhëza, mjedra dhe manaferra
 - **Perimet**, ku përfshihen kultivimi i domates, specit, trangujt, sallatat, spinaqit dhe kultivimi i fidanëve të perimeve në serra.
-

-
- **Përpunimi shtëpiak**, ku përfshihen përpunimi i qumështit, pemëve dhe perimeve.
 - **Frutat malore dhe bimët mjekuese** ku përfshihet grumbullimi dhe tharja e frutave malore dhe bimëve mjekuese

Një ndër objektivat kryesore të IADK-së është rritja e përsheptuar e sektorit privat në bujqësi.

Nën objektivat e IADK janë:

- Përmirësimin e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese të fermerëve privat
- Përmirësimin e kontrollit të cilësisë së prodhimeve bujqësore
- Përmirësimin e lidhjeve zinxhirore të tregut
- Organizimin e fermerëve në shoqata të qëndrueshme
- Mbështetjen e njerëzve në asistencë sociale
- Organizimin e panairëve

Brenda çdo kllasteri ekipet tona synojnë që:

- Fermerët të rrisin aftësitë konkurruese në treg
 - Të zvogëlojnë mbështetjen e materialeve të importuara në sektorin e bujqësisë
 - Të përmirësojnë mjedisin në të cilin veprojnë fermerët, duke ju krijuar infrastrukturë më të mirë prodhuese dhe përpunuese.
 - Në bashkëpunim me institucionet përkatëse të bëjnë harmonizimin e ligjeve të bujqësisë.
-

Përfituesit direkt:

- 124 Familje kanë përfituar**, Inpute bujqësore për kultivim të fidanëve të perimeve, kornishonit, mekanizim bujqësor për pemë, pajisje për bletari, mëshqerra mbarrëse, pula vojse dhe ushqim të koncentruar
- 201 Fermer, Zyrtarë komunal për bujqësi dhe staf i IADK-së**, kanë marrë pjesë në 16 vizita: Kosovë (3) Maqedoni (2), Shqipëri (3) Mali i Zi (1), Bosnje e Hercegovinë (1), Kroaci (1), Slloveni (2), Suedi (1), Holandë (1) dhe Francë (1)
- 968 Fermer**, kanë marrë pjesë në 72 sesione të trajnimeve
- 4 Module të trajnimeve përpunim shtëpiak**, 88 ditë trajnime për 98 gra të certifikuar: Përpunim i qumështit, Përpunim i frutave dhe Përpunim i perimeve
 - 5 Panaire dhe ditë fushore**, 216 pjesëmarrës
 - 2 Publikime praktik**, 2 broshurë x 1000 kopje
 - 4 Partnerë ndërkombëtarë**, Mercy Corps, AFDI, PUM, USAID/KPEP

Kllasteri i Blegtorisë

Përmirësimi i kualitetit të qumështit

Për të përmirësuar kualitetin e qumështit, gjatë vitit 2010 IADK ka ndihmuar 35 fermerë nga komunat e Vushtrrisë, Skënderajt dhe Mitrovicës me pajisje higjienike. Secili fermer ka përfituar nga një pako higjienike e cila përmban: acid dhe bazë për pastrimin e pajisjeve mjelëse, dezinfektues të gjirit, jod, test për zbulimin e mastitisit (CMT), tri lloje të brushave për pastrimin e makinave mjelëse dhe paloma për pastrimin e gjirit të lopës. Qëllimi i projektit ka qenë që fermerët të trajnohen në aplikimin e procedurave për prodhimin e qumështit kualitativ, duke përfshirë praktikën e mira të mjeljes, pastrimit adekuat të makinave mjelëse, ruajtjen dhe transportin e qumështit deri tek përpunuesi. IADK ka monitoruar dhe trajnuar fermerët për gjashtë muaj. Mostrat e qumështit janë marrë në baza mujore dhe janë dërguar për analiza në laboratorin e qumështit të Agjencisë së Veterinarisë dhe Ushqimit në Prishtinë.

Në bazë të udhëzimit administrativ të Ministrisë së Bujqësisë MA-NR 20/2006 lidhur me kualitetin e qumështit dhe kategorizimin e qumështit të freskët, qumështi duhet të paguhet në bazë të kualitetit (numrit të gelizave somatike dhe mikroorganizmave). Në bazë të këtyre

parametrave IADK ka përgatitur databazën e fermerëve në të cilën janë llogaritur humbjet dhe fitimi i fermerëve në prodhimin e qumështit. Për të llogaritur këto të dhëna, IADK ka grumbulluar të dhënat e kualitetit të qumështit para se të intervenohet me pajisjet higjienike dhe trajnimin e fermerëve. Mesatarja e numrit të qelizave somatike në fillim të projektit ka

qenë 591,000/ml, ndërsa numri i mikroorganizmave ka qenë 2,416,000/ml qumësht. Nga këto të dhëna kemi konkluduar se kualiteti i qumështit



është shumë i dobët dhe fermerët kanë humbje të mëdha edhe në sasi të qumështit dhe kjo rezulton me të hyra të vogla në fermat e tyre.

Si rezultat i trajnimit të fermerëve dhe aplikimit të pajisjeve adekuate për

pastrim të makinave mjelëse, numri i qelizave somatike është ulur prej 591,000 në 388,000 ndërsa numri i mikroorganizmave është ulur prej 2,416,000 në

429,000. Ky përmirësim i kualitetit të qumështit ka rezultuar me rritjen e të hyrave ekstra të fermerëve të cilët kanë kaluar në ekstra klasë. Rritja e të hyrave ekstra është prej 66€ deri në 118 €uro në muaj. Nga 35 fermerët të cilët kanë qenë të përfshirë në program 40 % e tyre kanë kaluar në ekstra klasë.

Gjatë implementimit të projektit janë mbajtur shtatë trajnime me fermerët e përfshirë në program. Trajnimet janë mbajtur në mënyrë teorike dhe praktike.





Trajnimi i studentëve të fakultetit të Veterinarisë në përmirësimin e kualitetit të qumështit

Gjatë këtij viti IADK ka implementuar projektin "Organizimi i punës praktike të studentëve në përmirësimin e kualitetit të qumështit direkt në ferma" të donatorit Programi për Ndërmarrje Private të Kosovës (KPEP) i USAID-it. Programi ka zgjatur pesë muaj (mars- shtator) në të cilin kanë qenë të përfshirë 15 studentë të Fakultetit të Veterinarisë. Studentët kanë punuar 3 ditë në javë direkt me 159 fermerët të cilët dorëzojnë qumësht në pesë qumështoret më të mëdha të Kosovës: Vita, Bylmeti, Abi, Magic Ice dhe Kabi.

Për të gjithë studentët IADK ka organizuar 5 trajnime teorike dhe praktike; 2 trajnime me ekspertë të jashtëm nga Holanda dhe Franca dhe 3 trajnime nga ekspertë të IADK-së. Për të arritur objektivin e



projektit IADK ka pajisur secilin student me pajisje bazë për përmirësimin e kualitetit të qumështit. Në këtë mënyrë studentët kanë trajnuar fermerët në mënyrë praktike në fermë në përmirësimin e kualitetit të qumështit.

Qumështoret kanë ngritur cilësinë e prodhimeve finale, kanë rritur besimin tek konsumatorët si dhe kanë kontribuar në 20% të shpenzimeve të studentëve.

Shoqata IADK ka marrë një eksperiencë të mirë në organizimin e programeve të këtilla dhe në të ardhmen do ta ketë më të lehtë implementimin e tyre.

Shpërndarja e makinave mjelëse

Në mënyrë që fermerët të përmirësojnë kualitetin e qumështit dhe që të ndimohen fermerët nën asistencë sociale, gjatë vitit 2010 IADK ka bërë shpërndarjen e 3 makinave mjelëse për tre përfitues. Dy përfitues janë gra nga komuniteti shqiptar dhe një përfitues është nga komuniteti serb. Përfituesit janë nga komuna e Vushtrrisë dhe Skënderajt.



Inseminimi artificial

Një ndër problemet kryesore që fermerët hasin në riprodhim është kualiteti i dobët i materialit gjenetik që importohet prej demave jo të certifikuar dhe pa pedigree. Për të zgjidhur këtë problem, IADK këtë vit ka importuar 1000 doza të materialit gjenetik të racave të ndryshme; 600 doza të racës Simmental, 200 doza të racës Holstein i Zi dhe 200 doza të racës Holstein i Kuq.

Vend origjina e materialit gjenetik ka qenë nga Amerika nga kompania World Wide Sires (WWS). I gjithë materiali gjenetik që është importuar është shpërndarë në 7 stacionet veterinare të komunave të Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skënderajt dhe poashtu janë pajisur edhe dy veterinarë të rinj të cilët janë trajnuar mbi inseminimin artificial. Dy veterinarët e rinj së pari janë trajnuar për mënyrën e inseminimit artificial në mënyre praktike dhe teorike dhe pastaj atyre u janë dhuruar pajisje për inseminim artificial

si: kontonjer 20 litërsh, kontonjer 3 litërsh, mikroshiringje, pinceta dhe termos.

Pas shpërndarjes së materialit gjenetik në shtatë stacione të veterinarisë dhe te dy veterinarët praktikantë, IADK ka përgatitur data bazën për mbajtjen e shënimeve për inseminimin artificial të kafshëve, dhe duke bërë monitorimin e tyre. Ne bazë të monitorimit, del se është shfrytëzuar **99 %** e materialit gjenetik dhe sipas rezultateve të veterinarëve materiali gjenetik që është importuar nga IADK ka treguar rezultate të mira ngaqë përqindja e inseminimit të lopëve ka qenë prej **75 %** deri në **94 %**.



Krahasuar me përqindjen e inseminimit që veterinarët e kanë pasur më herët, përqindja e inseminimit është rritur prej **25 %**. IADK do të bëjë monitorimin e rregullt në përcjelljen e lindjes së viçavedhe ruajtjen e bazës gjenetike tek lopët e inseminura.

Gjatë implementimit të projektit IADK ka angazhuar ekspertë të veterinarisë nga Holanda dhe Shqipëria për trajnimin e fermerëve dhe veterinarëve praktikant. Dy veterinarët të cilet i kanë përcjellur trajnimet e organizuara nga IADK dhe të cilet janë pajisur me pajisje për inseminim artificial kanë mbajtur trajnime për fermerët nga komunat e Vushtrrisë dhe Skenderajt. Secili veterinar ka mbajtur nga tri trajnime ku numri i përgjithshëm i fermerëve të trajnuar është 90 fermerë.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrjes në trajnim ka qenë 134 duke përfshirë fermerë, studentë të fakultetit të Veterinarisë dhe veterinarë nga komuna e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skënderajt.

Përgatitja e silazhës së misrit

Një ndër problemet më të mëdha për përgatitjen e ushqimit të silazhuar është mungesa e pajisjeve adekuate për përgatitjen e silazhës së misrit. Duke e ditur se silazhi i misrit është ushqim i lirë, kualitativ dhe ulë koston e prodhimit, IADK këtë vit ka ndihmuar dy fermerë me makina për korrijen e silazhës së misrit. Përfituesit janë nga komuna e Vushtrisë dhe Skenderajt.



Të dy përfituesit gjate këtij viti i kanë përdorur makinat e silazhës në mënyrë të duhur dhe kanë kryer shërbime edhe për 46 fermerë të tjerë nga komunat e Vushtrisë dhe Skenderajt. Numri i përgjithshëm i sipërfaqes së korrur me silazhe të misrit ka qenë 46 ha, ku çmimi mesatar për ha ka qenë prej 170 €/ha për fermerët të cilët kanë qenë anëtarë të shoqatave dhe 200€/ha për ata që nuk kanë qenë anëtarë të shoqatave. Të hyrat e përgjithshme për të dy përfituesit kanë qenë rreth **8500 €**.

Pas shfrytëzimit të makinave të silazhit në mënyrë adekuate dhe në kohën e duhur, fermerët kanë përmirësuar kualitetin e silazhës së misrit e cila ka rezultuar rritjen e prodhimtarisë së qumështit. Në mënyrë indirekte nga ky projekt kanë përfituar 46 fermerë. Në bazë të të dhënave të fermerëve, kualiteti i silazhës së misrit është rritur prej **30%** deri në **40 %** si rezultat i trajnimeve dhe korrijes në kohën e duhur të silazhit të misrit.



Përpunimi i koncentratit

Duke parë nevojat e fermerëve për koncentrat të kualitetit të mirë IADK gjatë vitit 2010 ka ndihmuar tre përfitues me makina për përpunimin e koncentratit: mulli për prodhimin e koncentratit, makinë për qepjen e thasëve, peshore dhe një sasi të konsiderueshme të thasëve për paketim. Në projekt propozim është paraparë që IADK të ndihmoj vetëm një përfitues por pas hapjes së ofertave është konstatuar se ofertuesit kanë ofruar çmim të volitshëm, dhe me këtë rast është marrë vendim që të themelohen tri qendra për përpunimin e koncentratit. Dy përfitues janë nga komuna e Vushtrrisë dhe një nga komuna e Skenderajt.



Kapaciteti i mullirit është 500 kg/orë. Secili përfitues është trajnuar në përdorimin e makinave dhe poashtu u janë përgatitur 19 racione të ndryshme për lloje të ndryshme të kafshëve, në mënyrë që përfituesit të kenë mundësi të prodhojnë koncentrat me një kosto më të vogël për lloje të ndryshme të kafshëve. Në tre muajt e fundit sasia e përgjithshme e përpunimit të koncentratit është rreth **38,700 kg**, ku çmimi mesatar ka qenë rreth 0.25€/kg. Të hyrat e përgjithshme nga përpunimi i koncentratit janë rreth **9,675 €**.



Kllasteri i Hortikulturës

Pilot projekti për kultivimin e manaferrës dhe mjedrës

Në këtë aktivitet kanë përfituar 5 fermerë nga komunat Skënderaj (2), Vushtri (2) dhe në Podujevë (1).

Me të gjithë përfituesit është nënshkruar kontratë tri palëshe “IADK - Komuna të cilës i ka takuar – Përfituesi” në të cilën janë specifikuar të gjitha obligimet dhe detyrat e palëve kontraktuese duke përfshirë edhe participimin me 20% të vlerës së projektit.



Secili përfitues me kohë është furnizuar me nga një pako për kultivimin 1000m² të mjedrës dhe manaferrës: fidanë manaferre (*Loch Ness, Jumbo*) 375 copë, fidanë mjedre (*Autumn Bliss, Willamete, Polka*) 240 copë, gërshërë për krasitje, pompë spërkatëse CP3 20 L, pleh mineral 50 kg NPK 15:15:15), pako të pesticideve, rezervar për ujitje 1000 L, sistemin e ujitjes pikë – pikë, sistemin mbështetës (*shtyllat e betonit, ankerët përforcues, burginë për hapjen e vrimave dhe telin*).

Përkundër disa vonesave në mbjelljen e fidanëve për shkak të reshjeve të vazhdueshme, të gjithë përfituesit kanë arritur që ti kryejnë të gjitha punët në ngritjen e parcelave me manaferrë dhe mjedër. Për derisa manaferra nuk hynë në frutdhënje në vitin e parë të mjedra kultivarët Autumn Bliss dhe Polka kanë dhënë frutat e parë ku mesatarisht janë marrë nga 80kg për përfitues dhe janë shitur me një çmim mesatar prej 1.30 € në tregjet lokale. Vjelja ka filluar që nga muaji Gusht dhe ka vazhduar deri në fund të Tetorit.



Për përfituesit janë organizuar tri trajnime me tema praktike mbi mbjelljen dhe kultivimin e manaferrës dhe mjedrës. Në këto trajnime kanë marrë pjesë edhe fermerë tjerë të interesuar dhe numri mesatar i pjesëmarrësve për një trajnim ka qenë 12 fermerë. Pastaj ata në mënyrë të vazhdueshme janë këshilluar dhe monitoruar direkt në fermë, duke filluar nga përgatitja e tokës, mbjellja vendosja e sistemit mbështetës, mbrojtja nga sëmundjet dhe dëmtuesit dhe mirëmbajtja e parcelave. Të gjithë përfituesit janë furnizuar edhe me material edukues, broshura praktike për kultivimin e mjedrës dhe manaferrës si dhe skica teknike për mbjelljen e manaferrës dhe mjedrës.

Shtatë përfitues të pemishteve me mollë nga 0.5ha

Për këtë komponentë kanë shprehur interesim e tyre 60 fermerë prej të cilëve janë përzgjedhur 7 sish. Përzgjedhja e fermerëve përfitues është bërë në dy faza:

- Faza e parë është bërë një vlerësim teknik profesional nga një komision i përbërë prej ekspertëve të IADK-së dhe komunave përkatëse.
- Në fazën e dytë të gjithë kandidatëve të para kualifikuar që i kanë plotësuar më së miri kushtet i janë bërë analizat agrokimike të tokës.

Përzgjedhja e përfituesve është bërë në tri komuna Vushtrri (5), Skenderaj (1) dhe Zubin Potok (1).

Me të gjithë përfituesit është nënshkruar kontratë tri paleshe "IADK - Komuna e të cilës i ka takuar – Përfituesi" në të cilën janë specifikuar të gjitha obligimet dhe detyrat e palëve kontraktuese duke përfshirë edhe participimin 20% të vlerës së projektit.



Secili përfitues me kohë është furnizuar me nga një pako për ngritjen e 0.5 ha të pemishtes intensive me mollë: fidanë "knip" të mollës të certifikuar në nënshartesë M9 (*Jonagold, Delishec i artë, Greni smith, Gala dhe Breburn*)

1125 copë, 2 palë gërshërë për krasitje tip “kuker”, pompë spërkatëse CP3 20 L, pleh mineral 50 kg NPK 15:15:15), pako të pesticideve, rezervar për ujitje 1000 L, sistemin e ujitjes pikë – pikë, sistemin mbështetës (shtyllat e betonit, telin, bambusë, ankerët përforcues, burginë për hapjen e vrimave).



Mbjellja është bërë me kohë optimale, me material fidanor të cilësisë së lartë i cili është sjellë nga Bosnja dhe Hercegovina sipas standardeve bashkëkohore me distanca të mbjelljes 3.7 x 1.1 m. Disa përfitues kanë arrit që ta vendosin edhe sistemin mbështetës.

Me përfituesit e pemëve janë mbajtur 11 sesione të trajnimeve me tema të ndryshme të cilat janë të lidhura me ngritjen dhe mirëmbajtjen e pemishteve. Përveç përfituesve të këtij projekti në trajnime kanë marrë pjesë edhe fermerë tjerë ku mesatarja e pjesëmarrësve për një trajnim ka qenë 13 fermer. Të gjithë përfituesit janë monitoruar dhe këshilluar direkt në fermë gjatë tërë procesit të ngritjes së pemishteve. Gjithashtu përfituesit janë furnizuar edhe me broshura praktike për pemë dhe skica detale për ngritjen e pemishteve të përgatitura nga stafi i IADK-së.

Mulcher

Me qëllim të mirëmbajtjes më të lehtë dhe më kualitative të pemishteve, për fermerët pemëtar është siguruar një mulqer i cili është i dedikuar për korjen e barit dhe imtësimin e degëve të pemëve pas krasitjes. Ky mjet i është dhuruar falas shoqatave të fermerëve pemëtar të regjionit, të krijuara nga IADK. Shfrytëzimi i këtij mulqeri është përcaktuar me kontratë mes IADK-së, SHF „Frutikultura” dhe Departamentit të Bujqësisë në Vushtrri. Këtë mjet do të mund ta shfrytëzojnë edhe fermerë tjerë por natyrisht me çmim me të lartë të



përdorimit, në raport me anëtarët e SHF. Mulqeri është blerë si rezultat i kursimeve të bëra gjatë implementimit të projektit.

Tetë serra nga 200m² dhe inpute përcjellëse

Janë përkrahur 8 përfitues prodhues të perimeve me nga një pako gjithëpërfshirëse e cila ka përmbyajtur: **ngritjen e serrave 200m²** (serrat me montim, folja e zezë plastike për sistemi i ujitjes pikë- pikë rezervari për ujitje 1000 L, sistemi i mbështetjes), **inputet bujqësore** (fidanë të perimeve spec, domate, trangull dhe sallatë, plehrat kompleks granulë dhe kristalorë, pesticidet, pompë spërkaste CP3 20 L)

Përzgjedhja e përfituesve është bërë në bashkëpunim me shoqatat e fermerëve prodhues të perimeve dhe departamentet komunale për bujqësi në komunat Vushtri, Skenderaj, Mitrovicë, Podujevë dhe me Zyrën Lokale të komuniteteve në fshatin Çabër, komuna e Zubin Potokut



Është arritur që me kohë të bëhet furnizimi dhe montimi i serrave, pastaj furnizimi me inpute dhe fidanë cilësor të perimeve. Vlen të theksohet se furnizimi me fidanë të perimeve është bërë nga fermerët të cilët në vitin 2009 janë mbështetur nga projekti i FCA. Kompletimi dhe mbjellja e serrave është bërë në fund të muajit Prill. Vjelja e trangullit ka filluar në fund të muajit Maj dhe në fillim të Qershorit, e specit në gjysmën e Qershorit, e domates në fillim të Korrikut dhe sallata nga fillimi i Dhjetorit.

Struktura e kulturave në sipërfaqen e përgjithshme prej 1600 m² për tetë përfitues ka qenë: 336 m² me spec, 933 m² me domate dhe 300 m² me trangull. Nga tetë përfitues katër prej tyre kanë kultivuar spec, domate dhe trangull, një prej tyre ka kultivuar spec dhe domate, një ka kultivuar domate dhe trangull dhe dy kanë kultivuar vetëm domate. Ndërsa në fund të sezonit veror të gjithë kanë mbjellë nga 1600 kokë sallate.

Çmimi mesatar i sallatës ka qenë 0.25€/kg dhe të ardhurat mesatare nga kjo kulturë kanë qenë 400€ për përfitues. Pra të ardhurat për një përfitues

kanë qenë të ndryshme varësisht se si e kanë gjet tregun ato minimale kanë qenë 1300€ ndërsa ato maksimale 2300€. Mesatarja e përgjithshme për një përfitues të serrës 200m² kanë qenë 1700€.

Rezultatet e përfituesve të prodhimtarisë në serra

Muaji	Rezultatet e përgjithshme									Totali i shitjes SDT	Konsumi familjar kg		
	Spec			Domate			Trangull				Spec	Domate	Trangull
	Kg	Euro /kg	Tot Euro	Kg	Euro/ kg	Tot Euro	Kg	Euro /kg	Tot Euro				
Qershor	148	0.59	86.9	0	0	0	1558	0.41	632	719	27	0	196
Korrik	564	0.73	411	2861	0.47	1341	1342	0.41	547	2299	116	226	140
Gusht	594	0.69	409	6076	0.46	2807	907	0.26	237	3453	434	316	113
Shtator	477	0.59	280	5517	0.41	2287	246	0.65	161	2728	328	394	124
Tetor	122	0.55	66.7	3109	0.39	1214	0	0	0	1281	54	192	0
Total	1905	0.66	1253	17562	0.44	7650	4053	0.39	1576	10479	959	1127	573
Mes. Perfit.	238	0.66	157	2195	0.44	956	507	0.39	197	1310	120	141	72

Me përfituesit e serrave janë mbajtur 9 sesione të trajnimeve me tema të ndryshme duke filluar nga prodhimtaria e fidanëve përgatitja e serrave, mirëmbajtja e serrës, mbrojtja plehërimi, ujitja, teknologjinë e kultivimit të specit, domates, trangullit, dhe sallatës. Përveç përfituesve të serrave në trajnime kanë marrë pjesë edhe fermerë të tjerë ku mesatarja e pjesëmarrësve për një trajnim ka qenë 10 fermer.



Të gjithë përfituesit janë monitoruar dhe këshilluar direkt në fermë gjatë tërë periudhës së prodhimtarisë ku mesatarisht te secili fermer janë zhvilluar nga 9 vizita. Përfituesit janë furnizuar edhe me

broshura praktike për serra dhe skica detale për mbjelljen e perimeve në serrë të përgatitura nga stafi i IADK-së.

Përfituesit e serrave kanë qenë po ashtu edhe pjesë e programeve tjera të IADK-së ku kanë marrë pjesë në dy vizita të fermerëve me qëllim të këmbimit të eksperiencave, një vizitë në Kosovë dhe një Shqipëri. Gjithashtu ata kanë marrë pjesë me prodhimet e tyre edhe në Panairin regional për Bujqësi në Mitrovicë të organizuar nga IADK.

Në fund me të gjithë përfituesit është bërë vlerësimi i rezultateve të aktivitetit dhe janë nxjerrë rekomandime të përbashkëta për planin e kultivimit të serrave për vitin e ardhshëm. Ata janë ndarë shumë të kënaqur me rezultatet e arritura dhe eksperiencën e fituar.

Tetë serra nga 100m² dhe inpute përcjellëse

Janë përkrahur 8 gra me nga një pako gjithëpërfshirëse e cila ka përmbytur: **ngritjen e serrave 100m²** (serrat me montim, folia e zezë plastike për mulqirim, sistemi i ujitjes pikë pikë, rezervari për ujitje 1000 L, sistemi i mbështetjes), **inputet bujqësore** (farë të trangullit kornishon dhe spinaqit, plehrat kompleks granul dhe kristalorë, pesticidet, pompë spërkatse CP3 20 L) **edukim profesional** (4 sesione të trajnimeve). Përfitueset kanë qenë nga lokalitetet e pjesës veriore të Mitrovicës (Suhodoll, Kroj i Vitakut, Vinarc) dhe Zveqanit (Kelmend).



Pas mbarimit të sezonit të kultivimit të trangullit kornishon në fund të tetorit është vazhduar me mbjelljen e spinaqit.

Me përfituesit e serrave janë mbajtur 3 sesione të trajnimeve me tema të ndryshme duke filluar nga prodhimtaria, përgatitja e serrave,



mirëmbajtja e serrës, mbrojtja, plehërimi, ujitja, teknologjia e kultivimit të ,
trangullit kornishon dhe spinaqit.

Të gjithë përfituesit janë monitoruar dhe këshillat direkt në fermë gjatë
tërë periudhës së prodhimit. Gjithashtu përfituesit janë furnizuar edhe
me broshura praktike për kultivimin e perimeve dhe skica detale për
mbjelljen e perimeve në serrë të përgatitura nga stafi i IADK-së.

Pika grumbulluese të frutave pyjore


Realizimit të këtij aktiviteti të ri fillimisht i ka paraprirë hulumtimi i rrjetit të
grumbullimit të frutave pyjor dhe bimëve mjekuese në zonat rurale të
regionit të Mitrovicës. Njëkohësisht është bërë edhe promovimi projektit
nëpër zonat ku grumbullohen këto prodhime. Dy përfituesit janë nga
Fshatrat Bajgorë dhe Broboniq komuna e Mitrovicës. Secili prej tyre ka
marrë nga një tharëse elektrike me kapacitet 2 m³ dhe një makinë për
prerjen e kërpudhave. Për të dy përfituesit është mbajtur një trajnim për
përdorimin e pajisjeve.

Gjithashtu atyre u është përgatitur nga një fletore për mbajtjen e
shënimeve mbi grumbullimin dhe shitjen prodhimeve pyjore.

Gjatë këtij viti janë grumbulluar 5 lloje të bimëve mjekuese (*Agulicja*,
kamomili, *shtogu*, *gentiana dhe bliri*), 2 lloje të kërpudhave (*pankushja*
dhe dhelparakja) dhe 6 lloje të frutave pyjor (*boronica*, *molla e egër*,
dardha e egër kaça, *murri* dhe *dëllinja e zezë*). Është arrit që në dy
PGFP të grumbullohen 83000 kg të këtyre prodhimeve me një çmim
mesatar 0.71 € ose gjithsej 59250 €. Nga kjo vlerë kanë përfituar 160
familje nga 27 fshatra të ndryshme të komunës së Mitrovicës mesatarisht
370 € për familje.

Një pjesë të prodhimeve të grumbulluara nga fshatarët janë tharë me
pajisjet që i kanë marrë nga IADK dhe një pjesë janë shitur të freskëta në
një Qendër grumbulluese më të madhe. Pastaj nga kjo qendër janë
eksportuar në vende të ndryshme jashtë Kosovës. Nga sasia e
përgjithshme e prodhimeve të grumbulluara 83000 kg, prej tyre 14400 kg
është tharë dhe i është rritur vlera për 42%. Dy pikat grumbulluese nga
shitjet e prodhimeve të freskëta dhe të thara kanë krijuar fitime prej 10758
€ ose mesatarisht mbi 5000 € për secilën nga PGFP.

Komora ftohëse Është mbështetur një Qendër Grumbulluese e frutave pyjor me komorë ftohëse 40 m³. Kjo qendër grumbullon fruta pyjor në nivel regional duke përfshirë edhe dy pikat e mbështetura nga IADK gjatë këtij viti. Kjo komorë do të ndihmojë në zvogëlimin e humbjeve gjatë qarkullimit të produkteve grumbullim – shitje.



Edukim i fermerëve

- 1. Promovimi i aktiviteteve me gra në zonat rurale - përpunimet shtëpiake**
 - 2. Organizim i fermerëve**
 - 3. Vizitat**
 - 4. Panairot**
 - 5. Trajnimet**
 - 6. Publikimet**
 - 7. Aktivitete me partnerë profesional internacional**
-

Promovimi i aktiviteteve me gra në zonat rurale – përpunimet shtëpiake

Në komunat Vushtri, Skënderaj, Leposaviq dhe Mirtovicë është bërë promovimi i projektit për edukimin e grave në zonat rurale ku është arrit të realizohen tri module të trajnimit: Moduli i Qumështit, Moduli i Pemëve dhe Moduli i Perimeve. Në bashkpunim me UNDP është zhvilluar edhe një modul shtesë i Perimeve.

Kriter për përzgjedhjen e vendeve për mbajtjen e moduleve të trajnimit ka qenë përzgjedhja e zonave rurale, kërkesat e grupeve të grave për këto module dhe ato vende të cilat kanë kapacitete për prodhimet e qumështit, pemëve dhe perimeve.

Moduli i Qumështit

Trajnimi për modulin e qumështit është mbajtur në komunën e Skenderajt ku janë përfshirë pesë fshatra të kësaj komune, dhe në Komunën e Leposaviqit në fshatrat Bistricë, Koshtovë dhe Cerajë. Në këto trajnime kanë marrë pjesë 15 kandidatë nga Komuna e Skenderajt dhe 24 kandidatë nga komuna e Leposaviqit.

Trajnimet kanë pasur 20 sesione, ku 30 % kanë qenë teorike dhe 70 % punë praktike në përpunim. Të gjitha kandidatet në fund të trajnimeve i janë nënshtruar testit për vlerësimin e njohurive të marra gjatë trajnimeve. Të gjithë kandidatet të cilat kanë treguar sukses në test janë certifikuar nga IADK dhe ato tani kanë njohuri për përgatitjen e 13 llojeve të djathërave në mënyra shtëpiake.



Grupet e grave të cilat janë certifikuar nga IADK kanë pasur mundësi që ti promovojnë produktet e tyre në panairin regjional që IADK ka organizuar

në Mitrovicë. Pas promovimit të produkteve dhe krijimit të lidhjeve nga IADK shumica e grave që prodhojnë produkte të qumështit kanë gjetur tregun si në Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri dhe Gjilan.

Duke parë kushtet e rënda të grave në fshatrat Bistricë, Koshtovë dhe Cerajë, IADK ka ndihmuar 25 gra të cilat kanë marrë pjesë në trajnime me pajisje për ruajtjen dhe paketimin e prodhimeve të përpunuara.



Gjatë vitit 2010 IADK ka angazhuar një asistente e cila ka ndjekur trajnimet që ka organizuar IADK në 2009 dhe e cila ka treguar rezultate më të mira. Asistentja e IADK-së i ka mbajtur trajnimet në fshatin Shtitaricë, komuna e Vushtrrisë, ku janë trajnuar 11 gra në përpunimin e 13 lloje të djathërave. Trajnimet kanë zgjatur në 20 sesione dhe në fund të trajnimit me 29 Prill 2010 të gjitha gratë janë certifikuar për prodhimin e djathërave shtëpiak.

Përpunimi i perimeve

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve përpunuese dhe trajnimit praktik të grupeve të grave, IADK në 2010 ka themeluar qendrën për përpunimin e perimeve në komunën e Vushtrrisë. Kjo qendër është pajisur me komplet pajisjet për përpunimin e perimeve. Përfituesja e cila ka përfutur këto pajisje ka filluar në përpunimin e 6 llojeve të perimeve si



ajvar, specat turshi, kornishon, sallatë të përzier, sos të domates dhe feferona.

Me qëllim të krijimit të emrit të logos unike, IADK ka përgatitur logon me emrin KonVita dhe ka përgatitur etiketat për secilin prodhim. Po ashtu IADK ka organizuar trajnime në marketing për përfituesen e pajisjeve për përpunimin e perimeve.



Moduli i Pemëve

Gjatë vitit 2010 IADK ka mbajtur 3 module të trajnimit për përpunimin e frutave. Këto module të trajnimeve kanë zgjatur nga 30 sesione të cilat janë mbajtur në komunën e Vushtrisë, Skenderajt në komunën e Mitrovicës ku kanë marrë pjesë 37 gra.

Në përfundim të trajnimit të gjitha kandidatet u janë nënshtruar testit për verifikimin e njohurive të arritura gjatë trajnimit. Pas përfundimit të testit kandidatët janë certifikuar nga IADK për përpunimin e 16 llojeve të frutave.

Grupet e grave të cilat janë certifikuar nga IADK kanë pasur mundësi që t'i promovojnë produktet e tyre në panairin regjional që IADK ka organizuar në Mitrovicë.



Moduli i Perimeve

Gjatë vitit 2010 IADK ka mbajtur tri module të trajnimit për përpunimin e perimeve. Moduli i parë është mbajtur në komunën e Skenderajit, ky modul ka pasur 30 seksione ku janë trajnuar 20 kandidatë nga pesë fshatrat e kësaj komune. Moduli i dytë i përpunimit të perimeve është mbajtur në Komunën e Mitrovicës ku edhe ky modul ka pasur 30 sesione dhe janë trajnuar 9 kandidatë nga 4 fshatrat e komunës së Mitrovicës.



Moduli i tretë i përpunimit të perimeve është mbajtur në komunën e Vushtrisë. Ky modul është mbajtur në qendrën e përpunimit të perimeve që IADK e ka ngritur gjatë vitit 2010. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 16 kandidatë. Trajnimi është realizuar në mënyrë praktike dhe teorike. Në këtë trajnim gratë kanë pasur mundësi të njihen edhe me pajisjet për përpunimin e perimeve.



Kandidatët që kanë treguar sukses në trajnim dhe testin përfundimtar janë certifikuar nga IADK për përpunimin e 18 llojeve të perimeve.

Trajnim në Marketing

Në vazhden e trajnimeve për përpunim, IADK gjatë këtij viti ka organizuar edhe trajnime në marketing për grupet e grave të cilat përpunojnë perime. Qëllimi i IADK ka qenë që gratë të fillojnë të bëjnë edhe promovimin e prodhimeve të tyre në mënyrë që të gjejnë treg të sigurt dhe të rrisin vlerën e prodhimeve finale. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 17 gra nga komuna e Vushtrisë.

Vizita studimore në shkëmbimin e përvojave

Gjatë vitit 2010 IADK ka organizuar vizita të ndryshme në Kosovë, Shqipëri dhe Francë me qëllim të shkëmbimit të përvojave me grupet e grave në këto shtete dhe për marrjen e njohurive të reja në aspektin e përpunimit të perimeve, frutave dhe qumështit.

Më 18 Mars 2010 është organizuar vizitë për fermerët e regjionit të Mitrovicës në Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Fushë Kosovë që ata të shkëmbejnë përvojat me fermerët e regjioneve tjera në Kosovë. Në këtë vizitë kanë marrë pjesë 11 fermerë nga komunat e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skenderajt. Gjatë kësaj vizite fermerët kanë pasur mundësi të shkëmbejnë përvojat në aspektin e të ushqyerit të kafshëve, menaxhimin e fermave dhe për sisteme të ndryshme të mjeljes.

Nga 24 deri 27 Maj 2010 është organizuar vizitë studimore në Shqipëri me grupet e grave për përpunimin e pemëve dhe perimeve në të cilën kanë marrë pjesë 8 gra nga komuna e Vushtrrisë dhe Skenderajt. Gjatë kësaj vizite ato kanë pasur mundësi të njihen me procesin e përpunimit të pemëve dhe perimeve në aspektin shtëpiak dhe në organizimin e shoqatave të grave në Shqipëri.

Me 15 Tetor është organizuar vizitë në Kosovë me grupet e grave në të cilën kanë marrë pjesë 33 gra me ç'rast janë vizituar përpunuesit e pemëve dhe perimeve në Pejë dhe Gjakovë. Gratë kanë pasur mundësi të njihen me procesin e përpunimit të perimeve dhe pemëve dhe kultivimin e mjedrave dhe manaferrave.

Nga 2 deri me 11 Nëntor IADK ka organizuar vizitë studimore në Francë. Në këtë vizitë kanë marrë pjesë 3 gra, dy fermerë të përpunimit të qumështit dhe një përfaqësues nga IADK. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë që gratë të njihen me procesin e përpunimit të qumështit në aspektin teknologjik dhe në përpunimin e llojeve të djathërave.

Me 24 Nëntor është realizuar një vizitë në Kosovë me dy grupet e grave të modulit të perimeve. Në këtë vizitë kanë marrë pjesë 41 gra dhe është realizuar në Krushë të Madhe, ku gratë kanë pasur mundësi të njihen me përpunimin e perimeve dhe organizimin e grave në pikën përpunuese .

Nr.	Vendi	Data	Nr. i pjesmarr.	Agjenda
1.	Kosovë (Shtimje, Ferizaj, Suharekë)	31.05.10	13	Prodhimtari e perimeve
2.	Maqedoni (Shkup,)	11-12.05.10	2	Konferenca rajonale Organizimi i Fermerëve
3	Shqipëri (Shkodër, Vorë)	21-24.06.10	8	Prodhimtaria e perimeve
4	Maqedoni (Prespë, Tetovë)	26-29.09.10	10	Pemëtari, Prodhimtari e mollës
5	Kosovë(Istog, Pejë, Gjakovë, Fushë Kosovë)	18.03.2010	11	Prodhimtria e qumështit
6	Holandë	10-17.10.2010	2	Prodhimtaria blegtorale
7	Shqipëri	24-27.05.2010	8	Perpunimi i pemeve dhe perimeve
8	Kosovë	24.11.2010	41	Përpunimi i pemeve dhe perimeve
9	Francë	02-11.11.2010	3	Përpunimi i qumështit
10	Kosovë (Pejë, Gjakovë)	15.10.2010	33	Përpunimi i pemeve dhe Perimeve

Organizim i fermerëve

Me sukses të plotë janë aplikuar të gjitha procedurat legale për regjistrimin e “Unionit të Shoqatave të Fermerëve në Regjionin e Mitrovicës - USHFRM. Tani këtë union e përbëjnë 17 organizata të fermerëve (15 shoqata dhe dy kooperativa) të cilat kanë për bazë zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë si në kultivimin e pemëve, perimeve, blegtori, bletari dhe mekanizëm bujqësor.

Gjatë vitit me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të USHFRM-së është mbajtur edhe një cikël prej 5 sesioneve të trajnimeve:

- Aspekte legale mbi themelimin e Unionit të Fermerëve (3 sesione)
- Trajnime mbi ngritjen e njohurive menaxhuese të organizatave (2 sesione)



Panaire

Në këtë vit IADK ka qenë bashëorganizator i “Ditës së Dredhzës 2010” dhe bartës kryesor i organizimit të “Panairit Regional për Bujqësi Mitrovica 2010”.

“Dita e dredhzës 2010”-është organizuar me 15 Qershor 2010 në qytetin e Skenderajt.

Në këtë promovim 50 fermerë nga gjithë Kosova i kanë ekspozuar prodhimet e tyre të dredhzës. Kanë marrë pjesë edhe një numër i madh i pjesëmarrësve të ftuar dhe i qytetarëve. Në kuadër të pjesëmarrësve ka qenë edhe Ministri i MBPZHR, Kryetari i komunës së Skenderajt, përfaqësues të komunave nga gjithë Kosova, KFOR-it, Organizatat dhe Institucione tjera. Si mbështetës të këtij organizimi kanë qenë edhe AZHR Veri dhe ProCredit Bank.

Në këtë promovim nga organizatorët u ndanë edhe një numër i mirënjohjeve.

Mirënjohjet për 4 fermerët më të mirë në Kosovë për kontributin e dhënë në prodhimin e dredhzës si

1. Prodhuesi më i mirë i fidanëve të dredhzës- Xhavit Mulaj, Llukë e Epërme, Deçan
 2. Prodhuesi më i madh i dredhzës- Armend Malazogu, Kravaricë Gjilan
 3. Prodhuesi më i mirë i dredhzës në fushë të hapur- Hamdi Hasani, Dabëllde, Viti
 4. Prodhuesi më i mirë i dredhzës në ambient të mbrojtur – Hetem Balaj, Llaushë, Skenderaj
-



Mirënjohjet për 3 organizata për kontributin e dhënë në kultivimin e dredhëzës në Kosovë

1. IADK-në
2. Inter Coperation
3. Care Internationale

Mirënjohjes për kontributin e dhënë në përpunimin e dredhëzës:

Hanumshahe Zeneli – Punëtore e IADK-së

Panairi Regional për Bujqësi "Mitrovica 2010"

Për herë të parë më 24 dhe 25 Shtator 2010 është organizuar me sukses **Panairi Regional për bujqësi – Mitrovica 2010** në qytetin e Mitrovicës. Ky panair është organizuar nga IADK në mbështetje edhe të USHFRM, KK Mitrovicë, KK Skenderaj, KK Vushtrri, OEK dhe AKB.




Mbi 100 prodhues të ndryshëm i kanë ekspozuar prodhimet e tyre për dy ditë radhazi në këtë promovim. Aty janë ekspozuar prodhime të bletëve, pemë, perime, përpunime tradicionale, prodhime industriale, punë dore etj. Ky panair ka zgjuar një kureshtje të madhe dhe ka pas një numër shumë të madh të vizitorëve jo vetëm nga qytetet e regionit por nga tërë Kosova.



Në këtë panair janë ndarë edhe një numër i mirënjohjeve për fermer, biznese, shoqata dhe institucione.

Publikimet

Janë publikuar dy broshura me tituj “Kultivimi i mjedrës dhe manaferrës” dhe “Kultivimi i perimeve në serra-përpunimi shtëpiak” për perime dhe qumësht. Këto broshura përmbajnë një material të pasur për nevojat e fermerëve një pjesë e të cilave paraqet edhe përvojën praktike të IADK-së me fermerë. Broshura “Kultivimi i mjedrës dhe manaferrës” është publikuar në 1000 kopje me mbështetjen e donatorit EED nga Gjermania. Ndërsa broshura “Kultivimi i perimeve në serra-përpunimi shtëpiak” është publikuar në 1000 kopje me mbështetjen e donatorit UNDP programi UNKT.



Aktivitetet me partneret e jashtëm

Shoqata AFDI nga Franca

AFDI është shoqatë e fermerëve me seli në Normandi të ulet të Francës. Bashkëpunimi me këtë shoqatë ka vazhduar edhe këtë vit dhe si qëllim kryesor ka qenë shkëmbimi i përvojave dhe ngritja profesionale e fermerëve të blegtorisë. Gjatë vitit 2010 janë realizuar dy vizita nga

përfaqësuesit e AFDIT në Kosovë për t'ju ndihmuar fermerëve në ngritjen e prodhimtarisë së qumështit dhe në përmirësimin e kualitetit të ushqimit të kafshëve.



Gjatë muajit Nëntor IADK ka organizuar një vizitë studimore France. Ne këtë vizite kane marre pjese 4 fermer nga komunat e Vushtrisë dhe Skenderajt dhe një përfaqësues i laboratorit të qumështit (AVUK). Kjo vizite ka zgjatur 12 dite. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë që fermerët të njihen me menaxhimin e fermave dhe organizimin e fermerëve në shoqata.



ne

Organizata PUM nga Holanda

Gjatë vitit 2010 IADK ka vazhduar bashkëpunimin me organizatën PUM, duke realizuar dy shkëmbime vizitash. Me kërkesë të IADK-së, gjatë muajit Maj në Kosovë ka qëndruar një ekspert i Veterinarisë. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë që trajnimi i fermerëve dhe veterinarëve në aspektin e inseminimit artificial. Me kërkesë të studentëve të Fakultetit të Veterinarisë, IADK ka angazhuar ekspertin nga Holanda që të trajnoj studentët në mënyrë praktike lidhur me inseminimin artificial dhe kontrollimin e mbarsmërisë së lopëve. Ne këtë trajnim kanë marre pjesë 13 studentë.



Gjatë muajit Tetor si rezultat i bashkëpunimit me organizatën PUM dy anëtarë të shoqatës së IADK kanë qëndruar në Holandë. Qëllimi i vizitës ka qenë njohja me përvojat e reja në blegtori dhe të thellimi i bashkëpunimit me organizatën PUM për vitet e ardhshme.

Ngritja e kapaciteteve të IADK-së

Trajnimet - me qëllim të ngritjes së kapacitetit të stafit të IADK-së për 7 persona nga ky stafit janë organizuar kurse përkatëse të gjuhës angleze. Kurset janë në vijim e sipër.

Marrja eksperiencës nga IADK

Dy studentë nga Universiteti I Prishtinës, një nga Anglia dhe një nga Franca (4 student) kanë përfunduar kurset e praktikantëve në IADK.

Web faqja - Është arritur që në aspektin teknik Web faqja e IADK-së www.iadk.org të jetë funksionale. Mirëpo edhe pse është filluar me vendosjen e disa të dhënave ka pasur vështirësi në mirëmbajtjen dhe vendosjen e vazhdueshme të dhënave nga stafi i IADK-së. Pengesa kryesore ka qenë se kjo punë paraqet një risi për stafin dhe kërkon kohë për përpunimin dhe vendosjen e të dhënave. Për këtë qëllim është paraparë që në të ardhmen të shihet mundësia e trajnimit të stafit nga kompania që e ka krijuar Web faqen.

Tregim suksesi për Xhafer Haradinaj

Xhafer Haradinaj është 53 vjeçar jeton në fshatin Stanovc komuna e Vushtrrisë bashkë me familjen 5 anëtareshe. Ai e ka traditë të merret me bujqësi dhe ka një fermë me 15 krerë të lopëve qumështore dhe një sipërfaqe prej 10 ha tokë bujqësore. Ferma është burim kryesor i sigurimit të



të ardhurave për familje. Familja e tij në vitin 2008 nga IADK ka përfituar pikën grumbulluese të qumështit dhe ka filluar me këtë aktivitet për herë të parë. Para se të themelohet pika grumbulluese e qumështit vet fermeri dhe fermerët tjerë të këtij fshati të gjithë sasinë e qumështit e kanë shitur

në tregun e gjelbërt në Prishtinë dhe vende tjera. Pika grumbulluese e qumështit në fshatin Stanovc është e pajisur me të gjitha pajisjet të cilat janë të nevojshme për grumbullimin e qumështit. Kapaciteti i pikës grumbulluese është 1100 litër qumësht në ditë. Në këtë pikë dorëzojnë qumësht 17 fermerë nga ky fshat dhe fshatra tërë.

Gjatë vitit 2010 IADK ka implementuar projektin e përmirësimit të kualitetit të qumështit ku kanë qenë të përfshirë 35 fermerë nga komunat e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skenderajt, dhe në këtë projekt ka qenë i përfshirë edhe fermeri Xhafer Haradinaj. Fermeri në fjalë me përpikëri ka ndjekur trajnimet dhe këshillimet nga IADK dhe ka arritur të përmirësojë kualitetin e qumështit, dhe të kalojë në ekstra klasë; dhe falë menaxhimit të mirë të fermës ka arritur të ngrisë prodhimtarinë e qumështit e të rrisë të hyrat në fermën e tij. Z. Haradinaj para fillimit të projektit për përmirësimin e kualitetit të qumështit ka qenë në klasë të tretë dhe është ndëshkuar nga qumështorja me 20 %, në bazë të udhëzimit administrativ mbi pagesën e qumështit.

“Me njohuritë e fituara nga trajnimet dhe këshillat e stafit të IADK, kam kaluar në ekstra klasë dhe tani kam rritur të hyrat në fermën time më shumë se 50 % në muaj”- shprehet Z. Haradinaj.

Me rritjen e të hyrave në fermën e tij, gjatë vitit 2010 Z. Haradinaj ka investuar në fermën e tij në blerjen e një laktofrizi të veçantë vetëm për qumështin e fermës së tij në mënyrë që ta ketë më mirë në kontroll kualitetin e qumështit.

Z. Haradinaj për të ardhmen mendon të rrisë fermën e tij, duke parë interesin nga ky biznes dhe duke pasur përkrahjen e dy djemve dhe familjes së tij. Me të hyrat nga prodhimi dhe grumbullimi i qumështit, Z. Haradinaj mbanë familjen 5 anëtarëshe, dhe shkollon vajzën në degën e Informatikës dhe djalë në degën e Veterinarisë.

Ai është shumë mirënjohës ndaj organizatës IADK për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme e cila ka bërë që ai ta ndiej veten më të sigurt në punën e tij.

Tregim suksesi nga Adem Fejzullahu

Është 43 vjeçar, jeton në fshatin Bajgorë komuna e Mitrovicës bashkë me familjen gjashtë anëtarëshe, gruan dy djemtë dhe dy vajzat e tij.



Duke jetuar në një fshat të thellë malor të rajonit të Shalës së Bajgorës, për të sigurimi i ekzistencës, plotësimi i nevojave familjare dhe shkollimi i fëmijëve paraqesin një sfidë në vete.

Ademi, falë dëshirës së tij për punë, iniciativës së Qendres Grumbulluese të Frutave Pyjor "Arena" nga komuna e Vushtrisë

dhe resurseve natyrore të rajonit ka hapur një perspektivë të re jo vetëm për familjen e tij por edhe për shumë familje të varfëra që jetojnë në rajonin e Shalës.

Këtë aktivitet Ademi e ka filluar para 4 viteve. Ai me familjen e tij kishte filluar mbledhjen bimëve dhe frutave të ndryshme në natyrë por edhe grumbullimin nga fshatarë të tjerë. Edhe pse fillimi si gjithnjë ishte mjaft i vështirë për shkak të mungesës së mjeteve financiare, pajisjeve të nevojshme për këtë aktivitet, mungesës së hapësirave adekuate, Ademi ishte i vendosur të zhvillojë edhe më tej këtë aktivitet.

Deri në vitin 2010 nuk kishin marrë asnjë mbështetje në aktivitetin e tij nga asnjë donator. Duke parë entuziazmin për punë dhe potencialin e lartë të resurseve natyrore dhe njerëzore në një ambient të pastër, ai më në fund gjenë një mbështetje për aktivitetin e tij. Në këtë vit mbështetet nga IADK përmes donatorit FCA nga Finlanda me një furrë për tharjen e frutave pyjorë me kapacitet 2m³ dhe një makinë për prerjen e kërpudhave.

Gjatë vitit 2010 Ademi ka grumbulluar rreth 36700kg të frutave dhe bimëve të ndryshme pyjore si: agulçe, shtog, kërpudha, gentiana, boronicë, mollë e egër, dardhë e egër, kaqë, murriz dhe dëllenjën e zezë. Rreth 3000 kg nga kjo sasi e grumbulluar ka arritur t'i thajë me pajisjet e

pranuara nga IADK. Nga ky grumbullim kanë përfituar mesatarisht rreth 200€ mbi 110 familje prej 20 fshatrave të ndryshëm të rajonit të Shalës. Ndersa vetë Ademi së bashku me familjen e tij ka siguruar rreth 5200€ nga ky aktivitet.

Kjo mbështetje për Ademin ka qenë shumë e mirëseardhur dhe planet e tij për të ardhmen janë rritja e këtij aktiviteti dhe përmirësimi i kushteve për të arritur rezultate sa më të larta.


Ademi është shumë mirënjohës ndaj organizatës IADK dhe stafit profesional të saj për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme e cila ka bërë që ai ta ndjej veten më të sigurt në punën e tij.

Stafii i IADK-së për vitin 2010

ZENEL BUNJAKU	Menaxhment	Drejtor Ekzekutiv
ESMA AZEMI	Financa	Zyrtare për financa dhe Administratë
ARIANA SELMANI	Financa	Zyrtare për Financa dhe Administratë
ELHEME SHALA	Administratë	Ndihmëse Teknike
PETRIT KOCI	Administratë	Ndihmës Teknik - IT
VAHID AVDIU	Pemëtari-hortikulturë	Inxhinier i Bujqësisë
RIFAT BAJRAKTARI	Bujqësi	Inxhinier i Bujqësisë
GURSEL ARIFI	Blegtori	Inxhinier i Bujqësisë
XHAVIT SHALA	Blegtori	Asistent i Blegtorisë
SKENDER FEJZULLAHU	Pemëtari-hortikulturë	Asistent i hortikulturës
HANUMSHAHE ZENELI	Përpunim	Zyrtare Projekti

Buxheti i IADK-së për vitin 2010

Donatorët	Të hyrat	Shpenzimet		
		Shpenzimet direkte	Shpenzimet e implementimit	Shpenzimet totale
Fin Church Aid	217,356	189,357	28,000	217,356
Evangelischer Entwicklungsdienst-EED	77,858	66,471	11,386	77,858
UNDP/ABD + LC	21,000	20,034	966	21,000
Mercy Corps	300		46	46
Komunat	200	200	-	200
LWF	3,057	1,370	1,687	3,057
KPEP	18,310	13,539	285	13,824
LC-FCA	23,565	23,565	-	23,565
ECLO	3,270	2,920	350	3,270
Total	364,916	317,456	42,719	360,175



Adresa
Rr Ulqinit Nr. 74.
40000 Mitrovicë
Kosovë/ a

www.iadk.org
info@iadk.org
Tel/Fax: +381 (0) 28 530 308
Mob: +377 (0) 44 198 056